



Prishtinë: 31.01.2022

Kodi i ZRRE-së: V\_1482\_2022

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2270\_12\_21** të dt. 02.12.2021;
- Ankesat e konsumatorit të dt. 19.04.2020, 29.11.2020, 23.12.2020, 20.01.2021;

në seancën e mbajtur më datë 31.01.2022 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e konsumatorit R.I., nga Komuna e Prizrenit.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2270\_12\_21, i datës 02.12.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 02.12.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2270\_12\_21, me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit R.I nga Komuna e Prizrenit, lidhur me kontestimin faturave, për shkak të dyshimit në matjen jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 20034668.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori R.I brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së për këto shkaqe:

- Vendimi i DMK-së është i mangët dhe i pa bazuar, sepse janë marrë parasysh vetëm raportet e personelit të KEDS-it;
- Konsumatori vazhdon të ketë dyshime për manipulim ose fryrje të faturave për muaj me radhë;
- Konsumatori kërkon anulimin e vendimit të DMK-së, me njoftimin që lëndën do ta procedojnë në gjykatë.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se vendimi është i mangët dhe i pa bazuar, Bordi thekson se, nuk qëndron një pretendim i tillë, për faktin se, me kujdes dhe ndërgjegje është analizuar çdo provë



veç e veç dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën, si në vijim: Procesverbalin për pranimin e instalimit elektrik të dt. 17.04.2019; Ankesat e konsumatorit të dt. 03.01.2020; Procesverbalin e inspektimit të dt. 06.01.2020; Përgjigjen e KESCO-s të dt. 05.02.2020; Ankesën e konsumatorit të dt. 19.04.2020, Vendimin e DMK-së të dt. 02.12.2021; Ankesën e konsumatorit të dt. 29.12.2021, dhe ka gjetur se, ankesa e konsumatorit R.I, është e pa bazuar.

Bordi pas analizimit të të gjitha dëshmive të paraqitura nga ana e konsumatorit dhe të licencuarit KESCO, ka vërejtur se, fillimisht, me datë 17.04.2019, punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 20034668, me të dhënat përkatëse si në vendimin e kontestuar. Dhe me datë 18.04.2020 Departamenti i Faturimit në KESCO e ka ngarkuar konsumatorin me faturën për shërbime – lidhje të re në vlerë prej 377.60 EUR si dhe ka hapur shifrën e re. Ndërkaq me datë 03.01.2020, konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumatorë në KESCO, me kërkesën që t'i bëhet ri shqyrtimi i faturave nga periudha shtator 2019 deri ne periudhën dhjetor 2019 për shkak te dyshimit ne matjen jo te saktë te njehsorit elektrik nr. 20034668. Bazuar ne kërkesën e konsumatorit, me datë 06.01.2020 punëtorët e autorizuar te KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse te konsumatorit ku kane evidentuar gjendjen e shpenzimeve ne njehsorin elektrik nr.20034668 ku TL=048145 kWh dhe TU=014169 kWh. Bordi ka gjetur se bazuar në shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit vërtetohet se shpenzimet e konsumatorit të evidentuara dhe faturuara në CCP në periudhën dhjetor 2019 përputhën me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit.

Me datë 07.02.2020 punëtorët e autorizuar te KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse te konsumatorit ku kane evidentuar gjendjen e shpenzimeve ne njehsorin elektrik nr.20034668 ku TL=059812 kWh dhe TU=019316 kWh. Bordi konstaton se bazuar në shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit vërtetohet se shpenzimet e konsumatorit të evidentuara dhe faturuara në CCP në periudhën janar 2020 përputhën me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit. Me datë 25.02.2020 punëtorët e autorizuar te KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse te konsumatorit ku kane evidentuar gjendjen e shpenzimeve ne njehsorin elektrik nr.20034668 ku TL=64629 kWh dhe TU=20396 kWh. Ekipi i KEDS-it ka bere shqyrtimin e tensioneve si dhe rrymave te cilat kanë qenë ne rregull, inspektimin e kyçje ve si dhe kane evidentuar ne procesverbal qe konsumatori nuk lejon ndërrimin e njehsorit me qellim te dërgimit për shqyrtim ne qendrën e kalibrimit. Bordi konstaton se bazuar në shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit vërtetohet se shpenzimet e konsumatorit të evidentuara dhe faturuara në CCP në periudhën shkurt 2020 përputhën me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit

Po ashtu me datë 11.06.2020 punëtorët e autorizuar te KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse te konsumatorit ku kane evidentuar gjendjen e shpenzimeve ne njehsorin elektrik nr.20034668 ku TL=071593 kWh dhe TU=021554 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar se është inspektuar njehsori si dhe instalimi ku kane evidentuar se çdo gjë është ne rregull, ku: njehsori është i bllobuar si dhe hyrjet daljet janë ne rregulle si dhe qe njehsori mbetet i bllobuar. Bordi konstaton se bazuar në shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit vërtetohet se shpenzimet e konsumatorit të evidentuara dhe faturuara në CCP në periudhën maj 2020 përputhën me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit.



Me datë 10.09.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrimin e njehsorëve elektrik kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 20034668 me gjendje TL=090293 kWh dhe TU=024961 kWh si dhe ka vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 20055649 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh.

Me datë 12.11.2020 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e detal për njehsorin elektrik nr. 20034668 me gjendje TL=090293 kWh dhe TU=024961 kWh ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik bllobat(vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime nuk ka, sistemet matëse janë rregull dhe se gabimi në matje është **-0.34%**. Bordi thekson se njehsori elektrik bazuar në Kodin e Matjes së OSSH-së është brenda kufirit të lejuar të gabimit në matje.

Më tej, Bordi ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit për tërë periudhën dhe konstaton se lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektim dhe lexime të rregullta mujore dhe pas krahasimit të shpenzimeve të konsumatorit me dy njehsorët elektrik, njehsorin kontestues nr. 20034668 dhe nr. 20055649 dhe konstaton se konsumatori ka shpenzime më të lartë me njehsorin nr. 20034668. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike me njehsorin kontestues nr. 20034668 mesatarja mujore e shpenzimeve për periudhën 07/2019 deri në periudhën 09/2020(10.09.2020) është **7,679 kWh/muaj** kurse me njehsorin e ri elektrik nr. 20034668 për periudhën 09/2020 deri në periudhën 11/2021 mesatarja mujore e shpenzimeve është **3,326 kWh/muaj**. Bazuar në analizat e rrjedhës së energjisë konstatohet se konsumatori me njehsorin e ri nr. 20055649 ka rënie të shpenzimit të energjisë elektrike prej **130%**. Po ashtu, Bordi ka shqyrtuar edhe shpenzimin për periudhën pas faturave kontestuese të njëjtë me dy njehsorët, periudhën 05/2020 deri në periudhën 09/2020 me njehsorin elektrik nr. 20034668 mesatarja e shpenzimit është **5,171 kWh/muaj** kurse me njehsorin e ri nr. 20055649 për periudhën 05/2021 deri në periudhën 09/2021 është **5,267 kWh/muaj**. Bazuar në të gjitha analizat e bëra, Bordi konstaton se konsumatori ka pasur shpenzime më të lartë për periudhën 09/2019 deri në periudhën 02/2020 me njehsorin kontestues por që periudha tjetër e shpenzimeve nga 03/2020 deri me datën e ndërrimit të njehsorit 10.09.2020 përputhët plotësisht me shpenzimet e regjistruara në njehsorin e ri.

Bazuar në të gjitha analizat e bëra konstatohet se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Andaj, në harmoni me nenin 48 të Ligjit nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Bordi i ZRRE-së i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e ankuesit dhe i ka analizuar të gjitha dëshmitë dhe provat që lidhen më rastin në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i



drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fund

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, Kryesues

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

---

Lutfije Dervishi, anëtare

---

Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit R.I dhe
- Arkivit të ZRRE-së.